




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KLLOKOTIT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kllokotit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kllokotit (KLI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kllokotit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Në Raportin Vjetor Financiar, pasuritë kapitale të prezantuara në vlerë 1,833,710€, janë të nënvlerësuar për 67,904€ për shkak të mos regjistrimit të pasurive.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Kllokotit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- B2 Mos përgatitja e raportit të inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve, si dhe mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria.
- B3 Komuna nuk kishte arritë të verifikoj 20% të pronave siç kërkohet me Ligjin e Tatimit në Pronë, Nr.06/L- 005.
- B4 Komuna nuk kishte arritë të paguajë faturat në afatin e paraparë ligjore

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kllokotit.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Klllokotit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Klllokotit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Klllokotit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Klllokotit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmiresim të mundshëm, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në kontekst të sistemeve financiare, fushat ku janë identifikuar dobësi me të theksuara janë: përgatitja e PFV-ve jo në pajim me kërkesat ligjore, të hyrat, obligimet, të arkëtueshmet si dhe pasuritë jo financiare, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur me poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, dhe të përmirësohen kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, të gjitha të persëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja B1 - Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës si dhe mos prezantimi i plotë i tyre në PFV

#### Gjetja

Sipas nenit 6 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu neni 11 paragrafi 1 dhe 2 i rregullores përcakton se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim dhe nuk zhvlerësohen.

Komuna nuk i kishte paraqitur në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ pagesat në vijim:

- Për projektin “Rikonstruimi dhe zgjerimi i ndriçimit rrugor për komunitat e Kllokotit” pagesën në vlerë 28,988€; dhe
- Për projektin “Riparimi i sistemit të kanalizimit në Kllokot dhe Mogille” pagesën në vlerë 20,000€.

Po ashtu, kemi vërejtur se blerjet e vitit 2023, për pasuritë nën 1,000€, në vlerë 18,915.55€, nuk ishin regjistruar në regjistrat kontabël. Me tutje, për pasuritë me vlerë nën 1,000€, komuna nuk ka evidenca (regjister) dhe nuk dihet vlera këtyre pasurive, softueri e-pasuria nuk përdoret, si dhe Komuna nuk ka të dhëna për stoqet.

#### Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës, rritë rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll, të gjitha pasuritë e sajë dhe të këtë mangësi në raportim duke bërë nënvlerësimin e pasurive në PFV.

#### Rekomandimi B1

Kryetari duhet të siguroj se zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe mirëmban regjistrat e pasurisë që disponon Komuna. Po ashtu Kryetari duhet t'i identifikoj dhe të vlerësoj të gjitha pronat që janë në pronësi të Komunës në mënyrë që raportimi dhe prezantimi i tyre të jetë i plotë dhe i saktë në PFV-ë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B2 - Mos përgatitja e raportit të inventarizimit para përgatitjes së PFV

**Gjetja** Sipas Rregullores Nr. 02/2013 - Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenet 18 dhe 19 si dhe paragrafët 4.6 dhe 4.7 përcaktojnë që komisioni për inventarizimin e pasurive jo financiare, përgatit raportin për kryerjen e inventarizimit si dhe hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Si dhe neni 6.3 përcakton se, pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të registrohen në sistemin "e-pasuria".

Komuna nuk na ka ofruar dëshmi së Kryetari kishte marr vendim për formimin e Komisionit për inventarizim të pasurive.

Mos kryerja e inventarizimit të pasurive kishte ndodhur për shkak të mos zbatimit të kontrolleve të brendshme për menaxhimin e pasurisë.

**Ndikimi** Mos kryerja e inventarizimit të pasurive para përgatitjes së pasqyrave financiare, si dhe mos funksionalizimi i sistemit të e-pasurisë reflekton negativisht në saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë dhe në prezantimin e tyre në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të themelojë komision për inventarizimin e pasurive dhe të sigurojë se procesi i inventarizimit të pasurisë kryhet me kohë, me qëllim të prezantimit të saktë dhe të drejtë në PFV.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B3 - Mosverifikimi i plotë i pronave komunale

**Gjetja** Sipas nenit 15.2 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20%, e të gjitha pronave brenda territorit të Komunes.

Komuna kishte faturuar tatimin në prone, por nuk e kishte bërë verifikimin për asnjë objekt apo parcelë.

Sipas zyrtarëve komunal mos verifikimi i pronës kishte ndodhur në mungesë të stafit dhe të sigurimit të teknologjisë e cila nevojitet për përkrahje të sistemit të tatimit në pronë.

**Ndikimi** Mos verifikimi i pronave për qëllim të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës aktuale të tatueshme si dhe të ndikojë në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të palualishme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Vonesa ne pagesën e faturave**

**Gjetja** Me nenin 39 te LMFP, kërkohet që çdo faturë e vlefshme për pagesë për mallrat dhe shërbime ose punë të paguhen brenda 30 ditëve kalendrike pas pranimit të fatures.

Nga testimet e bëra kemi vërejtur së një faturë me shumën prej 300,39€ nuk ishte paguar në afatin prej 30 ditësh dhe vonesa ishte 56 ditë.

**Ndikimi** Mos pagesa e detyrimeve brenda afatit ligjor rrite mundësinë që furnitorët t'i drejtohen përmbauesve dhe gjykatave të cilat krijojnë shpenzime shtesë për buxhetin e komunes.

**Rekomandimi B4** Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV të vitit 2023 ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 902,034€. Kjo vlerë përbëhet nga llogaritë e arkëtueshme për tatimin në pronë 635,068€, nga shfrytëzimi i pronës 6,375€, nga taksa komunale për biznese 137,375€, si dhe pagesat për mbeturina 123,216€.

#### Çështja B5 - Menaxhim jo i duhur i llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në perputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pages, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Sipas zyrtarëve të komunës në vitin 2023 nuk janë ndërmarr veprimet ligjore për të iniciuar procedurë të arkëtimit të detyrueshem.

Mungesa e përgjegjësisë së zyrtarëve komunal për ndërmarrjen e veprimeve konkrete ligjore përfshirë paralajmerimet e fundit para mbledhjes së detyrueshme, ka shkaktuar mos shlyerjen borheve vite me radhë.

**Ndikimi** Mos zbatimi i ligjit dhe rregulloreve që i japin komunes të drejtën për inkasimin e të arkëtueshmeve, ka ndikuar në rritjen e vazhdueshme të shumës së të arkëtueshmeve dhe kështu do të zvogëlohen gjithnjë e më shumë gjasat që borxhet të inkasohen.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurojë se do të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme nga të gjithë pronarët e pronave konform kërkesave ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>1,282,328</b>	<b>1,487,393</b>	<b>1,329,462</b>	<b>1,081,213</b>	<b>1,174,251</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	1,128,528	1,273,636	1,219,659	976,932	992,520
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	9,072	2,457
Të bartura nga viti i kaluar	0	59,615	49,888	34,339	95,925
Të hyrat vetanake	153,800	153,800	59,916	60,870	83,350
Donacionet e jashtme	0	343	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 205,065€. Kjo rritje është rezultat i grantit qeveritar për 145,108€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar për 59,615€ dhe financimi nga donacionet e jashtme 343€. Në vitin 2023, Komuna ka shpenzuar 89% të buxhetit përfundimtar ose 1,329,963 €, me një rritje prej 1% në krahasim me vitin 2022. Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>1,282,328</b>	<b>1,487,393</b>	<b>1,329,462</b>	<b>1,081,213</b>	<b>1,174,251</b>
Pagat dhe mëditjet	866,307	1,011,415	1,011,415	796,907	831,605
Mallrat dhe shërbimet	176,419	178,173	163,492	167,733	160,216
Komunalitë	70,000	78,044	30,123	23,011	40,068
Subvencionet dhe transferet	12,000	13,172	12,750	14,878	24,837
Investimet Kapitale	157,602	206,591	111,683	78,684	117,526

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 145,108€. Kjo rritje ishte si rezultat i rishikimit të buxhetit. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur si rezultat i të hyrave vetanake. Në këtë kategori shpenzimet ishin rreth 92% e buxhetit.
- Buxheti final për shërbimet komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur 8,044€. Në këtë kategori, shpenzimi i buxhetit ishte 39%.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 1,172€ krahasuar me atë fillestar, si rezultat i të hyrave vetanake. Shpenzimet ishin rreth 97% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 48,989€. Kjo rritje ishte si rezultat i hyrave vetanake të bartura dhe aktuale. Shpenzimet në këtë kategori ishte rreth 54% e buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga komuna në 2023 ishin në vlerë 166,519€. Në këtë vit të hyrat krahasuar me vitin 2022, ishin më të larta për 49% apo 55,124€.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>153,800</b>	<b>153,800</b>	<b>166,519</b>	<b>111,395</b>	<b>139,492</b>
Të hyrat tatimore	95,167	95,167	93,475	40,799	59,784
Të hyrat jo tatimore	58,633	58,633	73,044	70,596	79,708

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të analizoj arsyet se pse nuk janë kryer veprimet e përcaktuara me vendim dhe të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës të emëruar që procesi i inventarizimit të kryhet me kohë, me qëllim të prezantimit të saktë dhe të drejtë në PFV.	Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se në vitin 2023 nuk është bërë inventarizimi i pasurive	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë përgatitjes së PFV në mënyrë që tabelat dhe shpalosjet për vitin 2023 të mos përmbajnë gabime. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve.		I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Gjendje e njëjtë me periudhën paraprake.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e punonjësve për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jenë në gjendje të plotë të gjitha kriteret për pozitat përkatëse.		I zbatuar
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se, zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe mirëmban regjistrat e pasurisë që disponon Komuna. Po ashtu Kryetari duhet të identifikoj dhe të vlerësoj të gjitha pronat që janë në pronësi të Komunës në mënyrë që raportimi dhe prezantimi i tyre të jetë i plotë dhe i saktë në PFV-ë.	Edhe në testimet e kësaj periudhe kemi hasur mungësi në regjistrimin e pasurive	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se do të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme nga të gjithë pronarët e pronave konform kërkesave ligjore.	Edhe në testimet e kësaj periudhe kemi hasur mungësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Obligimet e paguara	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore.	Edhe në testimet e kësaj periudhe kemi vërejtur fatura të paguara më vonë	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme






Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.  
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



## Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIKA E KOSOVËS  
OPŠTINA KLOKOT / KOMUNA E KLOKOTIT  
Nr. 678 / 24.06.2024  
KLOKOT / KLOKOT

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Komuna e Kllokot/Opština Klokot/Municipality of Klokot*

---

**LETËR E KONFIRMIMIT**


Për pajtueshmërinë me gjetjete Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve


Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të komunes së Kllokotit, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Vladan Bogdanovic   
Kryetar i Komunës së Kllokotit  
Data: 24.06.2024



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.